



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË
KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR
TIRANË



Nr. 79 Akti
Datë 14. 07. 2020

Nr. 79 Vendimi
Datë 15. 07. 2020

V E N D I M

“PËR CAKTIMIN E MASËS SË SIGURIMIT”

Gjykata e Shkallës së Parë Për Krime të Rënda Tiranë e përbërë prej:

GJYQ TAR - KLODIAN KURUSHI

Asistuar nga sekretarja e seancës gjyqësore Nesila Xhemali, sot më datë 15. 07. 2020, mori në shqyrtim në dhomë këshillimi, kërkesën penale Nr. 258 Akti, që i përket :

KËRKUES :

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë “Kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar”, Tiranë përfaqësuar nga prokurorja ElidaKaçkini.

KUNDËR:

1. Personit nën hetim Niko Nika, i biri i Vasil-it dhe i Vasiliqi-s i datëlindjes 18.05.1955, lindur në Korçë dhe banues në Tiranë, me adresë banimi rruga “Elbasanit”, pallati “Klasik”, Njësia Bashkiake Nr.2 Tiranë, me arsim të lartë, me gjendje civile i martuar, me shtetësi Shqiptare, i dyshuar për kryerjen e veprës penale “Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike” më shumë se njëherë dhe kryer në bashkëpunim, “Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike”, të kryer më shumë se një herë, dhe “Falsifikim i dokumenteve parashikuara nga nenet 259, 245/1//2 dhe 186 i Kodit Penal, i panjoftuar nga gjykata.

2. Personit nën hetim Eda Myftari, e bija e Hyseni-t dhe e Eliverta e datëlindjes 07.01.1991, lindur në Ersekë dhe banuese në Tiranë, me adresë banimi sipas RGJC Selitë, Lagja nr. 13, Rr. “Kodra Diellit”, me arsim të lartë, me gjendje civile i martuar, me kombësi e shtetësi Shqiptare, e dyshuar për kryerjen e veprës penale “Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike” më shumë se njëherë dhe kryer në bashkëpunim, “Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë

banuese në Tiranë banuese në Komuna e Parisit, Pallati "Pastareli", e dyshuar për kryerjen e veprës penale "Korrupsion pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike" parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal, i panjoftuar nga gjykata.

8. Personit nën hetim Evald Bejaj: i biri i Kujtim dhe Bukuroshe, i datëlindjes 19.05.1990, lindur në Vlorë dhe banues në Tiranë, rruga "Sami Frashëri" P.10-1-5, i dyshuar për kryerjen e veprës penale "Shpërdorim detyre" parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, i panjoftuar nga gjykata.

9. Personit nën hetim Johana Sinani: e bija Ismailit dhe e Renatës, e datëlindjes 29.07.1991, lindur në Delvinë Sarandë dhe banuese në Komuna e Parisit, pallati përballë "Trend Caffë", e dyshuar për kryerjen e veprës penale "Korrupsion pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike" parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal, i panjoftuar nga gjykata.

10. Personit nën hetim Arjan Gjoka: i biri i Sadedin dhe Ruhije, i datëlindjes 25.05.1963, lindur dhe banues në Tiranë, Rruga Njësia bashkiake nr. 9, Mine Peza/196/2/16/1, i dyshuar për kryerjen e veprës penale "Shpërdorim detyre" parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, i panjoftuar nga gjykata.

11. Personit nën hetim Anda Muçaj: e bija e Bujarit dhe e Mimosës, e datëlindjes 24.10.1988, lindur në Tiranë dhe banuese në Tiranë, Njësia bashkiake nr. 5, Brigada 8 Kati2 Ap9/017/-, e dyshuar për kryerjen e veprës penale Korrupsion pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike" parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal, i panjoftuar nga gjykata.

12. Personit nën hetim Luiza Metani (Goduni), e bija e Irfanit dhe e Tanije-s, e datëlindjes 13.06.1972, lindur në Poliçan dhe banuese në Tiranë, më adresë banimi sipas RGJC Njësia Bashkiake nr. 7, Rr. "Artan Lenja" nr. 31, me gjendje civile i divorcuar, me arsim të lartë, me kombësi e shtetësi Shqiptare, e punësuar pranë Poliklinikës nr. 6, Tiranë, e dyshuar për kryerjen e veprës penale "Falsifikim i dokumenteve Shëndetësorë" parashikuara nga neni 188/2 të Kodit Penal, e panjoftuar nga gjykata.

13. Personit nën hetim Diana Hysi, e bija e Petraq dhe Kontesh e datëlindjes 17.01.1969, lindur në Berat dhe banuese në Tiranë, me adrese banimi sipas RGJC Njesia Bashkiake nr. 7, "Sali Butka", me gjendje civile e martuar, me arsim të lartë, kombësi e shtetësi Shqiptare, e punësuar pranë Poliklinikës nr. 1, Tiranë, e dyshuar për kryerjen e veprës penale "Falsifikim i



përkatëse.

Gjatë kontrollit Johana është telefonuar nga personi nën hetim Niko Nika me numër telefonik 068 44 44 44, i cili është ushtruar prej saj tek klinika "Zogu i Parë".

dokumenteve Shëndetësore" parashikuara nga nenet 188/2 të Kodit Penal, e panjoftuar nga gjykata.

14. Personit nën hetim Marinela Sulmina (Hysa) Bija, Shefqet-it dhe e Nexhmije-s, e datëlindjes 03.07.1978, lindur në Durrës dhe banuese në Tiranë, me adresë banimi sipas RGJC Njësia Bashkiake nr. 1, Rr. "Lili Tafaj", me gjendje civile e martuar, me arsim të lartë, me kombësi e shtetësi Shqiptare, e punësuar pranë Poliklinikës nr. 4, Tiranë e dyshuar për kryerjen e veprës penale "Falsifikim i dokumenteve Shëndetësore", parashikuara nga neni 188/2 të Kodit Penal e panjoftuar nga gjykata.

OBJEKTI:

Caktim mase sigurimit për të gjithë personat nën hetim.

BAZA LIGJORE:

Nenet 244, 245 e vijues të K. Pr. Penale.

Gjykata pasi shqyrtoi në dhomë këshillimi dhe vlerësoi në tërësi aktet përkatëse shkresore si dhe pasi e diskutoi çështjen në tërësi;

V Ë R E N

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë "Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar" Tiranë, ka regjistruar procedimin penal nr. 61, të vitit 2020 për veprën penale "Korrupsion pasiv të personave që ushtrjnë funksione publike" dhe "Shpërdorim të detyrës" parashikuar nga nenet 259 dhe 248 të Kodit Penal.

Rrethanat e faktit

Gjatë hetimeve të kryera në lidhje me këtë procedim penal, kanë rezultuar të dhëna që punonjës të Inspektoratit Shëndetësor Shtetëror, Dega Rajonale Tiranë dhe të Drejtorisë Rajonale të Operatorit të Shërbimit të Kujdesit Shëndetësor Tiranë dhe njësive vartëse të saj, Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Tiranë dhe Qendrat Shëndetësore, dyshohet se janë përfshirë në veprime të kundërligjshme që konsistojnë kryesisht:

- së pari në mosmarrjen e masave përkatëse administrative gjatë ushtrimit të kontrolleve pranë subjekteve tregtare, duke kryer mospërbushje të rregullt të detyrës;
- së dyti: në kërkimin dhe pranimin e përfitimeve materiale që lidhen me kryerjen ose moskryerjen e veprimeve që lidhen me detyrën e tyre.
- së treti: në ushtrimin e ndikimit të paligjshëm tek punonjës të tjerë shtetërorë, me qëllim kryerjen e veprimeve në mospërbushje të rregullt të detyrës,
- së katërti: në falsifikimin e dokumenteve shëndetësore, të pasqyruara si më poshtë: konstatuar shkelje dhe duke mos marrë masa përkatëse, fakte të cilat janë në hetim.

masave në kuadër të masave anti Covid-19, klinike e cila nuk ka respektuar protokollet përkatëse.

Gjatë kontrollit Johana është telefonuar nga personi nën hetim Niko Nika me numër telefonik 0692071544, i cili interesohet lidhur me kontrollin e ushtruar prej saj tek klinika "Zogu i Parë" pasi aty ka mbesën e tij. Johana i thotë i kanë komunikuar subjektit që është për gjorbë, ndërsa bashkëbiseduesi i thotë me thuj, që ti them unë sa, dhe flasim duke nënkuptuar vlera monetare. Në vijim, Johana është telefonuar sërish nga numri 0692071544, dhe nga konteksti i bisedave që bashkëbiseduesi përpiqet të ushtroje ndikim të paligjshëm ndaj shtetases Johana, kundrejt qëllimit të parregullt, me qëllim mos ndëshkimin e mase administrative të subjektet që është përfitim te parregullt. *Johana i thotë që fol vetë ti dhe flasim, por Niko i thotë sa ti thotë dhe në ushtruar kontroll. Johana i thotë si herën e parë dhe ai i thotë nëse bën ndonjë çik ulje. Johanën e bisedat në vijim ajo i thotë si herën e parë dhe ai i thotë nëse bën ndonjë çik ulje. Johanën e telefonon numri i telefoni 0692292506 i regjistruar në emër të shtetasit Enea Haxhiraj dhe e pyet për të njëjtin rast dhe ajo i thotë se nuk kishte asgjë as maska as doreza, as leje nga e-albania, as dezinfektimin nuk ua ka treguar.*

Në orën 12.38 ajo e merr në telefon personin nën hetim Niko Nika dhe i thotë pak a shumë aty

Nga pamjet filmike të siguruara rezulton fakti që Johana ka qenë bashkë me Evaldin dhe Arjanin tek subjekti Klinika "Zogu i parë" dhe nga bisedat e bëra rezulton se pavarësisht shkeljeve të konstatuara ata nuk kanë marrë masa. Ndërkohë Johana ka pranuar faktin se ka marrë përftimin material të ofruar nga personi nën hetim Niko Nika, ku në bisedat ndërmjet tyre referohet edhe për rastin e parë, ku nga tërësia e fakteve të krijohet dyshimi që bëhet fjalë për rastin e subjektit "Alb Market" sh.p.k.

Gjithashtu nga hetimi kanë rezultuar të dhëna nga bisedat telefonike që ky grup pune ka ushtruar kontrole dhe në subjekte të tjera, si hotele, furra buke, e të tjera duke konstatuar shkelje dhe duke mos marrë masa përkatëse, fakte të cilat janë në hetim.

Për sa i përket personave nën hetim Ornela Balla dhe Anda Muçaj rezulton se në datën 20.02.2020 personat nën hetim Ornela Balla dhe Anda Muçaj kanë shkuar për inspektim tek subjekti "Rrezet e Jete" me nr. Nipti L824070221 me adresë rruga "Nacionale Tiranë-Elbasan", fakte këto të konfirmuara nga përgjimet, ku nga komunikimet rezulton se personat nën hetim kanë përfituar shumën prej pesë mijë lekësh, të dhënë nga personi i quajtur Lili.

Këto fakte konfirmohen nga vëzhgimet ku rezulton se personat nën hetim Ornela Balla rreth orës 11.30 futet me mjetin me targa AA 187 brenda shtëpisë, ndërsa aty futet dhe mjeti me targa AA 059 PN dhe dalin rreth orës 13.15. Me shtetasen Ornela Balla dhe me të futet dhe automjeti me targa AA 059 rreth orës 13.15 dhe 13.40 se subjektet kanë shkuar atje me dy mjete. Nga përgjimet e komunikimet ku rezulton se Ornela ka biseduar me Andën në lidhje me shumën e parave të dhëna referuar transkripteve të përgjimeve.

Edhe në datën 26.02.2020 ora 12.26 ka biseda ndërmjet Eneas me Ornelën datë 26.02.2020, ku flasin që Enea po shkon tek subjekti "Rreze Jete" dhe Ornela i thotë që tja vërë inspektimin një muaj para.

Gjithashtu në datën 14.05.2020 ora 13.13 biseda ndërmjet Ornelës dhe Andës ku Ornela i thotë që është tek Mondit dhe e pyetur nëse i ka cuar certifikatë dezinfektimi se duhet të bëjnë akt

Gjatë hetimit është konstatuar një veprimtari e dyshuar si kriminale ku janë përfshirë punonjës të Njesisë Vendore të Kujdesit Shëndetësor dhe Qendrave Shëndetësore nr. 1, nr. 4 dhe nr. 6 Tiranë.

Personat nën hetim të përfshirë në këtë veprimtari të dyshuar si kriminale janë shtetasit Niko Vasi Nika, Hazis Halil Lura që janë të punësuar në Njesisë Vendore të Kujdesit Shëndetësor Tiranë, shtetasja Eda Hysen Myftari që është e punësuar në Drejtorinë Rajonale të Operatorit të Shërbimit të Kujdesit Shëndetësor, personi nën hetim Ihsan Tajar Ihsani, i cili deri në vitin 2018 ka qene i punësuar në Poliklinikën nr. 1, ndërsa aktualisht rezulton i dalë në pension personat nën hetim Ilir Kamber Hoxha dhe Luiza Irfan Metani mjekë në Poliklinikën nr. 6, Franc Daija, mjek në Poliklinikë nr. 4, i cili ka dalë në pension në muajin prill 2020 dhe në raste të veçanta me mjekë të tjerë, siç është rasti i personit nën hetim Diana Hysi, mjekë pranë Qendrës Shëndetësore nr. 1 apo Marinela Sulmina (Hysa) mjekë pranë qendrës Shëndetësore nr. 4, si dhe persona të cilët që janë administratorë apo lidhje të tjera të subjekteve tregtare, ku një pjesë e tyre janë të identifikuar gjatë hetimit.

Faktet, personat e përfshirë si dhe provat.

Drejtoria Rajonale e Inspektoratit Shëndetësor Shtetëror Tiranë.

Personat nën hetim Johana Sinani, Ornela Balla, Anda Muçaj, Arjan Gjoka dhe Evald Bejaj janë të punësuar si inspektorë pranë Inspektoratit Shëndetësor Tiranë, Dega Rajonale Tiranë. Johana Sinani, Evald Bejaj dhe Arjan Gjoka janë në grup pune së bashku, ku Johana është në detyrën e përgjegjëses, ndërsa shtetasja Ornela Balla është në grup pune me shtetasit Anda Muçaj dhe personin e quajtur Enea dhe Ornela është në detyrën e përgjegjëses.

Dy inspektorët Evald Bejaj dhe Johana Sinani në datën 17.02.2020 kanë ushtruar kontroll në marketin "Alb Market" sh.p. k ndodhur në rrugën "Jordan Misja", ku kanë konstatuar shkelje në lidhje me disa produkte dhe nuk kanë marrë masë administrative ndaj subjektit.

Johana me numër 0692261921 është telefonuar nga personi nën hetim i quajtur Niko Nika me nr. Telefoni 0692071544 ish-punonjës pranë të njëjtit institucion, aktualisht i punësuar pranë Njesisë Vendore, i cili i thotë se pronari i subjektit është i njohuri i tij dhe ta shohë me kujdes. Në përfundim Johana i thotë ishte copë copë, tek njëra pikë nuk kishte higjienë dhe tek pika në fjalë iu fshehën faktin e tregtimit të kripës, të cilën ata ua gjetën. Ajo thotë që ia kanë mbyllur në rregull dhe ai i komunikon që do t' ju thotë "për një kafe".

Fakti që dy inspektorët kanë qenë për kontroll tek ky subjekt provohet nga pamjet filmike të marra nga vetë ky subjekt, si dhe nga transkriptet e komunikimeve të bisedave të kryera ndërmjet personit nën hetim Johana Sinani dhe Niko Nika.

Personi nën hetim Johana Sinani bashkë me dy inspektorët e tjerë personat nën hetim Evald Bejaj dhe Arjan Gjoka në datën 16.05.2020 kanë shkuar për kontroll pranë subjektit klinike mjekësore "Zogu i Parë" ku kanë konstatuar shkelje të shumta në lidhje me mosmarrjen e



masave në kuadër të masave anti Covid-19, klinike e cila nuk ka respektuar protokollet përkatëse.

Gjatë kontrollit Johana është telefonuar nga personi nën hetim Niko Nika me numër telefonik 0692071544, i cili interesohet lidhur me kontrollin e ushtruar prej saj tek klinika "Zogu i Parë", pasi aty ka mbesën e tij. Johana i thotë i kanë komunikuar subjektit që është për gjobë, ndërsa bashkëbiseduesi i thotë me thuj, që ti them unë sa, dhe flasim duke nënkuptuar vlera monetare. Në vijim, Johana është telefonuar sërish nga numri 0692071544, dhe nga konteksti i bisedave që bashkëbiseduesi përpiqet të ushtroje ndikim të paligjshëm ndaj shtetasës Johana, kundrejt përfitimit të parregullt, me qëllim mos ndëshkimit e mase administrative të subjektet që është ushtruar kontroll. *Johana i thotë që fol vetë ti dhe flasim, por Niko i thotë sa ti thotë dhe në bisedat në vijim ajo i thotë si herën e parë dhe ai i thotë nëse bën ndonjë çik ulje.* Johanën e telefonon numri i telefoni 0692292506 i regjistruar në emër të shtetasit Enea Haxhiraj dhe e pyet për të njëjtin rast dhe ajo i thotë se nuk kishte asgjë as maska as doreza, as leje nga e-albania, as dezinfektimin nuk ua ka treguar.

Në orën 12.38 ajo e merr në telefon personin nën hetim Niko Nika dhe i thotë pak a shumë aty

Nga pamjet filmike të siguruara rezulton fakti që Johana ka qenë bashkë me Evaldin dhe Arjanin tek subjekti Klinika "Zogu i parë" dhe nga bisedat e bëra rezulton se pavarësisht shkeljeve të konstatuara ata nuk kanë marrë masa. Ndërkohë Johana ka pranuar faktin se ka marrë përftimin material të ofruar nga personi nën hetim Niko Nika, ku në bisedat ndërmjet tyre referohet edhe për rastin e parë, ku nga tërësia e fakteve të krijohet dyshimi që bëhet fjalë për rastin e subjektit "Alb Market" sh.p.k.

Gjithashtu nga hetimi kanë rezultuar të dhëna nga bisedat telefonike që ky grup pune ka ushtruar kontrole dhe në subjekte të tjera, si hotele, furra buke, e të tjera duke konstatuar shkelje dhe duke mos marrë masa përkatëse, fakte të cilat janë në hetim.

Për sa i përket personave nën hetim Ornela Balla dhe Anda Muçaj rezulton se në datën 20.02.2020 personat nën Ornela Balla dhe Anda Muçaj kanë shkuar për inspektim tek subjekti "Rrezet e Jetes" me nr. Nipti L824070221 me adresë rruga "Nacionale Tiranë-Elbasan", fakte këto të konfirmuara nga përgjimet, ku nga komunikimet rezulton se personat nën hetim kanë përfituar shumën prej pesëmijë lekësh, të dhënë nga personi i quajtur Lili.

Këto fakte konfirmohen nga vëzhgimet ku rezulton se personat nën hetim Ornela Balla rreth orës 11.30 futet me targa AA 187 brenda shtëpisë, ndërsa aty futet dhe mjeti me targa AA 059 PN dhe dalin rreth orës 13.15. Me shtetasen Ornela Balla dhe me të futet dhe automjeti me targa AA 059 rreth orës 13.15 dhe 13.40 se subjektet kanë shkuar atje me dy mjete. Nga përgjimet e komunikimet ku rezulton se Ornela ka biseduar me Andën në lidhje me shumën e parave të dhëna referuar transkripteve të përgjimeve.

Edhe në datën 26.02.2020 ora 12.26 ka biseda ndërmjet Eneas me Ornelën datë 26.02.2020, ku flasin që Enea po shkon tek subjekti "Rreze Jete" dhe Ornela i thotë që tia vërë inspektimin një muaj para.

Gjithashtu në datën 14.05.2020 ora 13.13 biseda ndërmjet Ornelës dhe Andës ku Ornela i thotë që është tek Mondit dhe e pyetur nëse i ka cuar certifikatë dezinfektimi se duhet të bëjnë akt

miratimin, për ambientin jo atë mbetjeje spitalore. Ajo i thotë jo. Anda e pyetur nëse e gjejnë dot ato një për Mondin dhe në vazhdimësi bëhen bisedat ndërmjet tyre për qëllim për të nxjerrë përfitime materiale.

Nga komunikimet telefonike rezultojnë se ata kanë ushtruar kontrolle dhe në subjekte të tjera, të cilat po i nënshtrohen hetimit për identifikimin e tyre dhe nëse kanë marrë masa apo jo.

Për sa i përket subjekteve ku rezulton që personat kanë ushtruar kontroll është kërkuar informacion nëse ndaj tyre është marrë ndonjë masë administrative dhe ka rezultuar se ndaj tyre nuk është marrë ndonjë masë përkatëse.

Veprimtaria kriminale nga punonjës të Drejtorisë Rajonale të Operatorit të Kujdesit Shëndetësor Tiranë, Njësisë Vendore të Kujdesit Shëndetësor dhe Qendrave Shëndetësore nr. 1, nr. 4 dhe nr. 6 Tiranë.

Operatori e ushtron veprimtarinë në nivel qendror dhe rajonal, ku përfshihet Drejtoria Rajonale Tiranë si dhe Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor, si dhe qendrat Shëndetësore përkatëse të cilat e ushtrojnë veprimtarinë e tyre në Tiranë. Detyrat e tyre janë ofrimi i shërbimeve bazë të shëndetit publik e kujdesit Shëndetësor.

Personat nën hetim të përfshirë në këtë veprimtari të dyshuar kriminale janë shtetasit Niko Vasil Nika, Hazis Halil Lura që janë të punësuar në Njësinë Vendore të Kujdesit Shëndetësor Tiranë, shtetasja Eda Hysen Myftari që është e punësuar në Drejtorinë Rajonale e Operatorit të Shërbimit të Kujdesit Shëndetësor, personi nën hetim Ihsan Tajar Ihsani, i cili deri në vitin 2018 ka qene i punësuar në Poliklinikën nr 1, ndërsa aktualisht rezulton i dalë në pension personat nën hetim Ilir Kamber Hoxha dhe Luiza Irfan Metani mjekë në Poliklinikën nr. 6, Franc Daija, mjek në Poliklinikë nr 4, i cili ka dalë në pension në muajin prill 2020 dhe në raste të veçanta me mjekë të tjerë, siç është rasti i personit nën hetim Diana Hysi, mjeke pranë Qendrës Shëndetësore nr. 1 apo Marinela Sulmina (Hysa) mjeke pranë qendrës Shëndetësore nr. 4, si dhe persona të cilët janë administratorë apo lidhje të tjera të subjekteve tregtare, ku një pjesë e tyre janë të identifikuar.

Nga hetimi i kryer vihet re një veprimtari e dyshuar kriminale e personave nën hetim e cila konsiston kryesisht:

në ndërmjetësimin, sigurimin dhe lëshimin e librezave shëndetësore dhe vërtetimeve mjekësore për të punësuarit pranë subjekteve tregtare, pa u kryer procedurat përkatëse pranë mjekëve të familjes si dhe kundrejt përfitimeve materiale.

Përfaqësuesit e subjekteve tregtare me ndërmjetësimin e personit nën hetim Niko Nika, paguajnë shuma parash të cilat variojnë në varësi të njohjes apo sasisë që kërkohet, tek personi nën hetim Niko Nika, i cili nëpërmjet njohjeve të tij dhe lidhjeve të tij ua siguron ato nëpërmjet mjekëve të familjes, ku kryesisht vihet re një bashkëpunim me personat nën hetim Franc Daija ish mjek lagje në Qendrën Mjekësore nr. Nr .4 Kombinat, aktualisht në pension, Luiza Irfan Metani dhe Ilir Hoxha, mjekë pranë Qendrës Shëndetësore nr. 6 Kombinat dhe në raste të veçanta me mjekët e tjerë.

Për sa i përket mënyrës së lëshimit të këtyre librezave dhe vërtetimeve mjekësore lidhen me faktin se ato lëshohen pa u paraqitur personi për t' iu nënshtuar analizave apo vizitave, pa u



bërë shënimet përkatëse në regjistrat e vizitave, pa u bërë pagesat përkatëse për lëshimin e këtyre dokumenteve mjekësore, si dhe kundrejt përfitimeve materiale.

Në sigurimin e librezave të dezinfektimit apo kryerjen e analizave për ujin apo produkte të tjera në mënyrën fiktive për subjekte të ndryshme tregtare, pa u kryer kjo procedurë apo në ushtrimin e kontrolleve në subjekte tregtare qëllimisht për të nxjerrë përfitime materiale.

Personi nën hetim Niko Nika bashkëpunon vazhdimisht me personat nën hetim Eda Myftari dhe Hazis Lura, si dhe me subjekte tregtare

Nëpërmjet ndërmbjetësimit për të bërë të mundur kryerjen e tamponëve për konstatimin e virusit covid-19 jashtë procedurës normale për persona të ndryshëm, kundrejt përfitimit material.

Personi nën hetim Niko Nika bashkëpunon vazhdimisht me personin nën hetim Eda Myftari, ku kjo e fundit merr përsipër me njohjet e saj pranë Institutit të Shëndetit Publik të mundësojë marrjen e tamponit, deri në fund në marrjen e vërtetimeve përkatëse për analizën.

Nga përgjimet e komunikimeve të kryera nga personi nën hetim Johana Sinani kanë rezultuar të dhëna për personin nën hetim Niko Nika, me numër telefoni 0692071544. Ky i fundit është vënë në përgjim. Ai rezulton të ketë qenë më parë inspektor pranë Degës Rajonale të Inspektoriatit Shtetëror Tiranë, fakt i cili shpjegon edhe njohjen me Johanën dhe aktualisht punon pranë Njesisë së Kujdesit Shëndetësor Mjekësor Tiranë pranë Operatorit të Shërbimit të Kujdesit Shëndetësor. Ai është në grup pune me personi nën hetim Hazis Lura me nr. Telefoni 0685818935 dhe njëkohësisht ka njohje edhe me personin tjetër nën hetim Eda Myftari me të cilën bashkëpunon vazhdimisht në veprimtarinë kriminale me numër telefoni 0693640745. Kjo veprimtari kriminale pasqyrohet si më poshtë:

B.1 Sigurimi dhe lëshimi i librezave dhe vërtetimeve Shëndetësore.

Rasti i subjektit tregtar Gazmend Shehi, i cili rezulton të ketë aktivitet tregtar "Vila Shehi" me nr nipti L11428030D ku personi nën hetim Niko Nika i siguron librezat dhe vërtetime, dhe certifikatë dezinfektimi kundrejt pagesës përkatëse. Këto dokumente i siguron nëpërmjet infermieres të quajtur Fjori dhe mjekes Diana Hysi, të punësuarat pranë qendrës mjekësore nr. 1, dokumente të cilat janë lëshuar në mënyrë në fiktive, pa u bërë shënimet në regjistrin e vizitave dhe kundrejt pagesës prej tremijë lekësh.

Nga përmbajtja e transkripteve rezulton se personin nën hetim Niko Nika posedues i numrit telefoni celular 0692071544 në datë 01.06.2020, ka kryer biseda me shtetasin Gazmend Shehi posedues i numrit telefonik celular 0692209157, për ti siguruar atij nëpërmjet disa mjekëve të tjerë disa dokumente shëndetësor (libreza shëndetësore, certifikatë dezinfektimi) kundrejt vlerave të caktuara monetare. Shtetasi Gazmend Shehi, i dërgon me sms personit nën hetim Niko Nika të dhënat e subjektit «Vila - Shehi» me Nipt L11428030D, si dhe të dhënat e personave që do pajisem me librezat shëndetësore, përkatësisht Fatos Shehi 39 vjeç, Gazmend Shehi 41 vjeç, Artan Shehi - 40 vjeçe me profesion mësuese, si dhe Violeta Koni - 45 vjeçe. Kështu, në vijim të komunikimit mes tyre në datë 01.06.2020, ora 01:03 MD, personin nën hetimit Niko Nika i thotë shtetasit Gazmend Shehi «*Ti bëjnë me lekë, pesëmbëdhjetë mijë lekë copa ti bëjmë, më lirë nuk ka*“ ..., «*I bëjnë nga njëzet, njëzet e pesë po pesëmbëdhjetë tha ky shoku im*“, ndërkohe që në lidhje me certifikatën e dezinfektimit shtetasi Gazmend Shehi i thotë personit nën hetim Niko Nika: «*Ej na një të thjeshtë kështu, se e bëjme vete atë dezinfektimin*”.

Njëkohësisht, për sigurimet e librezave shëndetësore, personi nën hetim Niko Niko komunikon me personin që disponon numrin telefonik celular 0693346871, identifikuar si shtetasi Ihsan Ihsani, i cili orienton atë tek mjeket e Qendrës Shëndetësore nr. 1 Tiranë. Nga përmbajta transkripteve të komunikimeve të realizuara mes personit nën hetim dhe shtetasit Ihsan Ihsani, rezulton që shtetasi Niko Nika ka shkuar në QSH nr 1, është takuar me infermieren e quajtur "Fjori" si dhe mjeken e quajtur "Diana". Në komunikimin e datës 01.06.2020 ora 06:14 MD, shtetasi Ihsan Ihsani e pyet: *"Po Flori s'ishte aty"*, personi nën hetim i thotë *"Ishte Flori (Fjori) pra, katër cope i dhash unë, i dhash tridhjetë mije leke, nuk e di do jete e kenaqme?"*, ndërsa shtetasi Ihsan Ihsani i thotë: *"Ou, e kenaqme që cke me të herë tjetër të lidh me Florin (Fjorin) unë..."*

Pasi ka siguruar dokumentet shëndetësore, të lëshuar në mënyrë fiktive nga personeli mjekësor, personi nën hetim Niko Nika ka lënë të takohet me shtetasin Gazmend Shehi, për t'ia dhënë ato. Me vendim të organit procedues, personi nën hetim është mbajtur në vëzhgim, nga ku është evidentuar fakti që në datë 02.06.2020 fillimisht ai është takuar më një person të identifikuar më emrin Franci (0692904438) përpara kafe "Europa". Nga raporti i vëzhgimit është evidentuar që shtetasi me emrin Franci i jep shtetasit Niko Nika dy zarfe me ngjyre të bardhe, ndërsa ky i fundit i jep atij vlera monetarë (para). Pasi ata ndahen nga njëri - tjetri, personi nën hetim Niko Nika leviz në këmbë për në drejtim të rrugës së Elbasanit, ngjitet në apartamentin e tij, dhe pas pak çastesh del serish me disa dokumente në dorë dhe qëndron pranë Stacionit të Autobusit. Në orën 13:43 min, aty është afruar me mjetin Volsvagen Touran me targë "AA984ID" shtetasi Gazmend Shehi (0692209157), i cili është takuar me personin nën hetimi Niko Nika, ndërsa ky i fundit i ka dhënë qesen me dokumente. Pasi ata janë ndarë shërbimet e policisë gjyqësore kanë ndërhyrë duke ndaluar mjetin me targë "AA984ID" dhe mundësuar administrimin/sekuestrimin në cilësinë e provës materiale të dokumenteve objekt hetimi (katër cope librezave shëndetësore, dëshmi - shërbimi D.D.D). Sekuestrimi i vendosur mbi dokumentet e sipërcituara, është vleftësuar me vendimin e organit procedues të datës 03.06.2020.

I pyetur në cilësinë e personit që tregon për rrethanat te hetimit shtetasi Gazmend Shehi, administrator i një subjekti tregtar në Gjokaj, Vorë deklaron se: katër librezave shëndetësore i ka tërhequr në datë 02.06.2020 në sportelet e Drejtorisë së Higjenes, kundrejt shumës prej 2.500 leke të reja secila, në total 10.000 lekë të reja, por atje nuk i kane dhënë faturë. Ndërsa, për dezinfektimin e ambientit ka paguar 3.000 lekë të reja, ka marre fature tatimore, por ai nuk mundësuar vënien ne dispozicion të saj.

Rezultojnë se librezat shëndetësore me nr. 0001965 dt 29.05.2020; nr 0002075 dt 29.05.2020; ne. 0002076 dt 01.06.2020; nr. 0002077 dt 01.06.202, perkatesisht në emer te shtetaseve Artan Shehi, Fatos Shehi, Violeta Koni dhe Gazmend Shehi jane lëshuar (plotësuar/nënshkruar/vulosur) nga mjekje familje Dr. Diana Hysi, me kod 3539103, ndërsa dëshmi shërbimit DDD (Dezinfektim – Dezinsktim - Deratizim) me nr 0000536 nga subjekti "Firma Delet".

Në vijim të hetimit të kësaj çështje shërbimet e policisë gjyqësore kanë këqyru dokumentin "Regjistri i vizitave të mjekut të Përgjithshëm dhe Familjes" për datat 29.05.2020 dhe 01.06.2020 që administrohet nga mjekja Diana Hysi, por nuk rezultojnë që në këtë dokument të jenë pasqyruar/hedhur të dhënat e shtetaseve Fatos Shehi, Arta Shehi, Gazmend Shehi dhe Violeta Koni.



Nga tërësia veprimeve hetimore lidhur me këtë episod, të tilla si sekuestrimet e dokumenteve, përgjimet telefonike etj, rezultojnë që dokumentet e sipërcituar janë lëshuar në mënyrë fikse nga personeli mjekësor në QSH nr 1 Tiranë, pa ndjekur procedurën e rregullt ligjore që duhet të ndiqet. Më konkretisht personat (pacientet) nuk i janë nënshtruar kontrollit fizik mjekësor, nuk figurojnë regjistruar në regjistrat mjekësor, nuk janë banorë të zonës QSH Nr. 1, dhe nuk ka paguar tarifën fikse prej 100 lekë të vjetra. Madje, rezultojnë që vetëm pasi shërbimet e policisë janë paraqitur për të kryer verifikime në QSH Nr 1, në datë 03.06.2020 mjekja Diana Hysi ka prerë mandat arkëtimet dhe i ka paraqitur si prove për të justifikuar veprimet e saj. Për të mbuluar veprimet e paligjshme të saj, ajo ka vijuar të kryej komunikime me personin nën hetim Niko Nika, i cili i ka siguruar katër librezat e sipërcituar nga personeli mjekësor, kundrejt veprimit korruptiv, për t'ja dhënë me pas personit të interesuar (porositesit) Gazmend Shehi.

Rezultojnë që edhe dokumenti dëshmi shërbimit D.D.D me nr 0000536, në të cilin përshkruhet se është kryer shërbim Dezinfektim – Dezinsektim - Deratizim në datë 01.06.2020 është lëshuar me mënyrë fikse, fakt ky që del nga traskiptimi i komunikimeve telefonike të kryera nga personi nën hetim Niko Nika me shtetasin Gazmend Shehi.

B.I.2 Rastet ku personi nën hetim Niko Nika bashkëpunon me mjekun Franc Daija, mjek pranë Qendrës Shëndetësore nr. 4 Tiranë. Ky i fundit për shkak të daljes së tij në pension e lidh atë me mjekun tjetër Marinela Hysa.

a) Në datë 29.05.2020, ora 07 :30 MD, nga numri telefonik celular 0693640745 në posedim nga shtetasja Eda Myftari është dërguar SMS kundrejt numrit telefonik celular 0692071544 në posedim nga shtetasi Niko Nika me tekst: “Majlinda Valteri Dt. 23.05.1972, Rr. Bilal Golemi ka familja Bar Kafe Banakiere të dyja i do“.

Në datë 30.05.2020, ora 06:22 MD, personin nën hetim Niko Nika telefonon numrin celular 0692904438 në posedim nga mjeku i thërritur “Franci“, të cilin ai e pyet: “... hë më ka naj shpresë”, ndërsa bashkëbiseduesi i përgjigjet “Po nga java tjetër besoj se do e mbarojmë. Niko i thotë “Ato tjerat ja ktheva mbrapsht unë asaj, ik bëj në vend tjetër i thash“, ndërsa Franci i thotë: “Ti heqin këto njëher pataj flasim, pa problem“.

Në datë 02.06.2020, ora 11:15 PD, shtetasi Niko Nika telefonon serish mjekun e thërritur Franci (0692904438), të cilin e pyet nese do bëhen sot, ndërsa Franci i pohon për dhjetë minuta, ose çerek ore. Në komunikimin e orës 12:49 MD, ata lënë të takohen tek kafe “Europa“. Nga raporti i vëzhgimit është evidentuar fakti që shtetasi i identifikuar me emrin Franci i jep shtetasit Niko Nika dy zarfe me ngjyre të bardhe, ndërsa ky i fundit i jep atij vlere monetare (para).

Në datë 04.06.2020, ora 01:53 MD, nga numri telefonik celular 0692099342 (regjistruar në emër të shtetasës Merita Nora) është dërguar SMS kundrejt numrit telefonik celular 0692071544 në posedim nga shtetasi Niko Nika me tekst: «Kopshti Puffi. Anita Shehaj 54 vjec. Miranda Visha 52 vjec. Flm“.

Menjëherë me pas, në orën 01:55 MD, personi nën hetim Niko Nika telefonon mjekun me emrin Franci (0692904438), të cili i thotë: “Për ja dy cope, po qe se ke ti jap mbasdite emrat“, ndërsa Franci i thotë: “Po, mi jep mbasdite ti Niko“.

Ne datë 05.06.2020, ora 10:30 personi nën hetim Niko Nika telefonohet nga mjeku me emrin Franci (0692904438), i cili i bën me dije se në orën dy e gjysëm ai do shkoj në punë, ato ke të mbaruara. Niko i thotë ti marr me vetë, pasi do vij ti marr nesër në mëngjes

c) Në datë 05.06.2020, ora 03:31 MD personi nën hetim Niko Nika telefonohet nga numrin 0692098525, i cili i thotë për të hënën me duhet ajo, ta bëjnë dhe të shkoj ta marr, si dhe i dërgon të dhënat "Albana Packolli - 48 vjeç". Menjëherë me pas, shtetasi Niko telefonin mjekun e thërritur Franci (0692904438), të cilit i kërkon ti gjej një karton për shtetasen në fjalë, dhe se personi i interesuar do vij ti marri të hënën me mëngjes.

Ne datë 10.06.2020, ora 11:13 min, personi nën hetim Niko Nika telefonohet nga numrin telefonik celular 0693359880 në posedim nga personi i thërritur Marko, i cili kërkon të bëj disa librezat shëndetësore, si dhe analiza uji. Niko merr përsipër sigurimin e librezave dhe bërjen e analizave të ujit, ndërsa në vijim i identifikuar me emrin Marko i jep të dhënat: "Marko Duka datëlindja 27 vjeç", "Anxhela Llënga - 30 vjeç", "Denisa Lala - 25 vjeç", "Lindita Alla - 29 vjeç", si dhe niptin e subjektit "M01411028V" me vendodhje në Rr. "Albano Polis".

Menjehere me pas në orën 11:29 PD, personi nën hetim Niko Nika telefonin mjekun me emrin Franci (0692904438), të cilit i jep katër emrat e personave të sipërcituar, për pajisjen e tyre me librezat shëndetësore.

Në vijim, të komunikimeve mes tyre, në datë 11.06.2020, ora 05:12 MD, personi nën hetim telefonon personin e interesuar me emrin Marko (0693359880), të cilit i thotë: "uji del nesër, po mud ta marrin te henen, kurse keto kartonat i kam me vete, i mora tani" dhe lënë të takohen tek rruga e Elbasanit, për t'ja dhënë ato (librezat) në mbas ditën e po asaj datë.

Nga verifikimet në sistemin online të QKB-se, rezulton se shtetasi Marko Duka figuron i regjistruar si person fizik, me numër nipti M01411028V, me emrin tregetar "THE FUTURE", më objekt "Kopësht për Fëmijë".

Nga hetimi, rezulton që librezat shëndetësore në emër të shtetaseve Marko Duka, Anxhela Llënga, Denisa Lala dhe Lindita Alla etj janë plotësuar në mënyre fiktive nga personeli mjekësor dhe këto dokumente shtetasi Niko Nika i ka siguruar nga mjeku Franc Daija.

Nga operatori i telefonisë celulare "Vodafone" është konfirmuar që numri telefonik celular 0693359880 figuron i regjistruar në emër të shtetasit Marko Duka, i dtl 16.04.1993.

e) Më datë 11.06.2020, ora 09:28 min, personi nën hetim ka telefonuar mjekun e thërritur Franci (0692904438) të cilit i thotë "Është njëri që ka 100 cope nga ato" duke nënkuptuar librezat shëndetësore, ndërsa Franci i thotë nuk ka, por do të pyes një mjek tjetër, dhe të kthej përgjigje. Në vijim të këtij komunikimit Niko i thotë bashkëbiseduesit Franci: "I thuj ma co numrin me sms ti mu, po bie dakord ajo, ti bi unë ziles kur mos të jetë në punë ajo, që të jetë e qetë". Nga përmbajta e transkriptuar e komunikimeve në vijim rezulton që mjeku i emrin Franci (0692904438), e lidh personin nën hetim me mjekë të tjerë, për të siguruar prej tyre librezat shëndetësore.

Personi nën hetim Niko Nika bashkëpunon me mjeken Marinela Hysa (Sulmina me nr. telefoni 0692969301).

Në datë 14.06.2020, ora 12:10 MD, nga numri telefonik celular 0693640745 në posedim nga shtetasja Eda Myftari është dërguar SMS kundrejt numrit telefonik celular 0692071544 në posedim nga shtetasi Niko Nika me tekst: "**Jasmin Muca Dt.08.03.1994**". Menjëherë personi nën hetim Niko Nika telefonohet nga shtetasja Eda Myftari e cila i thotë i nisa dhe një tjetër duan nesër, ndërsa personi nën hetim Niko Nika i thotë ai shoku im ka dalë në pension dhe më dha numrin e një shoqes së vet, mjeke, ja çojmë nesër dhe i marrim nga dreka. Në vijim të këtij komunikimi personi nën hetim Niko Nika i referon personit shtetases Eda se: "**I thash do të marr unë në telefon kur të vish ti marrësh ato të dyja. Dhe ca te doje zemra i thuaj atyne. Jo tha, me thuaj sa bo. Nuk e di i thash unë. Se me tha mu sa 10 -të, 20 -të, nuk e di i thash unë, ata janë dy goca i thash unë, kanë nga një kalamo te dyja i thash unë, jepi për çuan**, ndërsa shtetasja Eda pranon ofertën/premtimin nga personi nën hetim Niko Nika.

Në datë 15.06.2020, ora 08:23 Pd, personin nën hetim Niko Nika telefonin numrin telefonik celular 0692273090 identifikuar gjate hetimit me emrin doktoreshe Marinela, të cilët i thotë kemi ja dy për të bërë, i duan të dyja dhe librezën dhe janë për punë. Ti coj më foto ?. bashkëbiseduesja i thotë: "**Mi co njiher por tek ajo e para kam veshtirësi se skemi ... megjithatë me co një here me foto te marr konfirmimin të telefon**", ndërsa personi nën hetim i thotë: "**Ti coj une, se nuk janë të miat, jane te një personi, mos ti coj në vend tjetër, ti marresh**". Në vjim të komunikimit mes tyre doktoreshe Marinela e pyet Nikon ky emri i pare ishte Gore Sotir, ndërsa shtetasi Niko i konfirmon emrin dhe mbiemrin.

Gjithashtu, në datë 15.06.2020, ora 11:20 shtetasi Marko Duka (0693359880), i dërgon personit nën hetim Niko Nika me SMS të dhënat e dy personave të tjere, përkatësisht "**Migena Mehmetaj 25 vjeç dhe Ariana Mullaj 38 vjeç**". Menjëherë me pas, personi nën hetim Niko Nika telefonon mjeken e identifikuar me emrin Marinela (0692273090) të cilës i thotë kemi dhe dy te tjera ti çoj, dhe i kalon të dhënat e dy shtetaseve të sipërcituar.

Personi nën hetim bashkëpunon me mjekët Ilir Hoxha dhe Luiza Meta pranë Qendrës Shëndetësore nr. 6, për lëshimin e vërtetimeve për subjektet tregtare Rasim Nela.

Në datë 12.06.2020, ora 09:16, personin nën hetim Niko Nika telefonon nga numrin telefonik celular 0682070590 identifikuar gjatë hetimit me emrin Rasim Nela, i cili i thotë po vjen ajo goca të bëj aplikimin, ndërsa Niko i thotë të shkruaj ujë rrjeti dhe të tjera. Në vijim të këtij komunikimi personi nën hetim e pyet shtetasin Rasimin "**Ti do vish per ate letren, per ate listen**", ndërsa ky i fundit i thotë: "**Po kur të jesh gati ti, vij unë**" dhe lënë të takohen më njëri - tjetrin.

Më pas, në orën 09:48 min personin nën hetim telefonon numrin 0682224140, indentifikuar me emrin Spiro (regjistruar në emër të Spiro Vangjeli), i cili i thotë: "**Ke pune me doktor Ilirin, çke ... takoje jam shoku Spiros, ... deri në orën një pa dhjetë të pret doktorri**". Pas kësaj bisede, personi me emrin Spiro, i dërgon personin nën hetim me sms numri e Dr. Ilirit "0682398509".

Në datë 13.06.2020, ora 08:38, personi nën hetim telefonon shtetasit Rasim Nela (0682070590), të cilit thotë asaj listë vëri numrat e kartës se identitetit anash për secilin, dhe do ti çosh më uat-cap tek ky numër telefoni 0682001021. Menjëherë me pas personi nën hetim Niko Nika telefonon numrin 0682001021, identifikuar emrin doktoreshe Luiza, të cilës i thotë jam doktor Niko që isha, do ti dërgoj ai me foto. Në orën 09:28 mjekja me emrin Luiza i konfirmon personit nën hetim Niko Nika marrjen listës, ndërsa në orën 09:37 nga numri i saj

0682001021, me personin nën hetim komunikon mjeku tjetër me emrin Ilir dhe përmbajtja e bisedës së zhvilluar mes tyre është si më poshtë vijon:

Iliri: Ke dërguar tek doktoresha listën, i ke dërguar të 35 - sta ?

Niko: Po 35 - së

Iliri: Okej atëherë po i bej unë, atë porosinë do e sjellës vetë ... ?

Niko: Urdhëro ?

Iliri: Ato porosinë

Niko: Po po, kur ti kesh gati më thuaj, dhe vij ti jap ty unë

Iliri: Okej

Niko: Ne rregull mos ki merak

Në datë 13.06.2020, ora 10:51, personi nën hetimi Niko Nika telefonon mjekun me emrin Ilir (0682398509) dhe përmbajtja e bisedës së zhvilluar mes tyre është si më poshtë:

Iliri + 509: Urdhëro

Niko + 544: Doktor Iliri, unë jam doktor Niko, ky është numri im, qe ta kesh

Iliri + 509: Okej, faleminderit doktorre

Niko + 544: Mir mbajte këtë ti, ajo doktoresha e ka ...

Iliri + 509: Okej, kur të mbarojmë të themi

Niko + 544: Po më bëj një telefon ... besoj për të hënë, s'mbarojnë sot ë

Iliri + 509: Unë po i bëj gati, të hënë i ke në dorë bësoj

Niko + 544: Po i bëtë sot, më bëj një telefon për sot

Iliri + 509: Do lëviz, jo se sdua ti bëj po unë ...

Niko + 544: Jo si të duash ti, të hënë leri, bëj për të hënë

Iliri + 509: Të hënë mbasditë i ke gati vëlla

Niko + 544: Je mbasditë të hënë në punë ?

Iliri + 509: Jam mbasditë javes tjetër

Niko + 544: Shumë bukur, vij unë i marr atje

Iliri + 509: Mir ardhesh atëherë. Faleminderit

Niko + 544: Fasim, më bëj një telefon edhe ... ky mbaje është numri im

Iliri + 509: Okej, mirupafshim.

Në datë 14.06.2020, ora 09:30 personi nën hetim Niko Nika telefonon serish shtetasin Rasim Nela (0682070590) të cilit i thotë nesër në mbas ditë do i marr ato, dhe e pyet: "Pagesën si e bën ti, kur të vijnë ato në dorë apo ?", ndërsa shtetasi Rasim i thotë "Kur të dush ti. Përpara me ca problemi ka, takona nesër mjes, dhe të jesh korrekt me atë gocën. Takona nesër mjes dhe pa problem fare".

Në orën 15.06.2020, ora 11:01 PD, personi nën hetim Niko Nika telefonon doktor Ilirin (0682398509) dhe ky i fundit i konfirmon që në orën 5 i ke gati (nënkupton librezat), ndërsa Niko i thotë kur të vij aty, spo futem brenda, hajde tek makina ime, mos ta marr vesh njëri.

b) Në datë 15.06.2020, ora 01:39 MD, personi nën hetim Niko Nika telefonin numrin telefonik celular 0692969301 identifikuar gjate hetimit me emrin Gjergji - "Akulllore Martini", të cilit i thotë kartat e identitetit te punëtorëve nisi me uat-cap tek numri 0685818935 (në përdorimi nga shtetasi Hasis Lura). Menjëherë me pas personi nën hetim Niko Nika telefonon doktor Ilirin (0682398509) të cilit i thotë: "Kam ja pese emra që nuk punojne, a mund ti coj ato kartat me

(shitatë) cope, por kjo i fundit thotë që s' kemi haber të mirë, ato sot kanë bërë tenderit, imagjino. Nga konteksti i bisedës del që Qendra Shtetësore ku është e punësuar mjekja Marina nuk ka kartoni librezash, por për të arritur qëllimin e tij menjëherë me pas personi nën hetim Niko Nika telefonin mjekun me emrin Ilir (0682398509) të cilit i thotë kam 7 (shatë) cope nga ato, të ti çoj me foto nga një numër tjetër. Mjeku me emrin Ilir i thotë okej, dhe e falënderon atë. Në vijim, personi nën hetim komunikon me personin e interesuar Kristaq Kolemiço dhe djalin e tij me emrin "Teo" të cilit i jep numrin e Dr. Ilirit (0682398509) me qëllim për ti çuar me uat - çap të dhënat e personave që do të pajisen me librezat shëndetësore. Në vijim të komunikimit mes tyre mjeku Ilir, i konfirmon personit nën hetim Niko Nika që librezat do ti ketë me vetë, dhe ata lënë të takohen për t'ja dhënë rreth orës 17:00 - 17:10 përpara kafe "Europa", Tiranë. Menjëherë me pas personi nën hetim Niko Nika ka telefonuar shtetasi emrin Teo (0692403864) të cilit i thotë i mora ato (nënkuptohet Librezat Shëndetësore) dhe ata lënë të takohen në Rrugën e Elbasanit, për t'ja dhënë ato.

Nga raporti i vëzhgimit rezulton që në datë 25.06.2020, ora 18:08 personi nën hetim Niko Nika është konstatuar poshtë pallatit të tij, dhe hipën në mjetin "Citroen" me ngjyre të zeze, me targa "AA266UB", automjeti i cili nga verifikimet në sistemin "E.Gjoha" rezulton në pronësi të shtetasit Teo Kristaq Kolemiço. Ai qëndron për çaste në mjet dhe me pas zbret prej aty dhe futet në banesën e tij.

Nga tërësia e veprimeve hetimore (transkriptet telefonike të kombinuara me raportet e shërbimit) në mënyrë të përmbledhur lidhur me këtë episod rezulton që nën hetim Niko Nika në datë 25.06.2020, kundrejt ndërveprimit korruptiv i ka siguruar shtetasit Kristaq Kolemiço (Kiqo) disa librezat shëndetësore, të plotësuar në mënyrë fiktive nga personeli mjekësor në Qendrën Shëndetësore Nr. 6 Tiranë, pa ju nënshtruar vizitave mjekësore, dhe ndjekur procedurën e rregullt ligjore. Këtë librezat shëndetësore janë siguruar nga personi nën hetim Niko Nika kundrejt vlerave të caktuara monetare pas komunikimeve të vazhdueshme telefonike dhe takimeve të drejtpërdrejta me subjektin Kristaq Kolemiço, djalin e tij Teo Kolemiço, si dhe mjekun Ilir Hoxha - përdorues i numrit telefonik celular 0682398509.

B.II. B.II. Në sigurimin e librezave të dezinfektimit apo kryerjen e analizave për subjekte të ndryshme tregtare, pa u kryer kjo procedurë apo në ushtrimin e kontroleve apo sajimin e tyre në subjekte tregtare qëllimisht për të përfitim material.

Në këtë veprimtari kriminale janë të përfshirë personat nën hetim Niko Nika, Eda Myftari dhe Hazis Lura.

Rasti ku subjekti tregtar "Linea Style" sh.p.k kërkon që ti bëhen analiza (uji akullore, e ëmbëlsira) bë kundrejt pagesën përkatëse. Në datë 05.06.2020, ora 11:12 personi nën hetim Niko Nika telefonohet nga numri telefonik celular 0693030433 (regjistruar në emër të shtetases Matilda Hoxha) e cila i thotë që po marr nga Cokolati-Italiani ku është menaxher Fatmiri dhe duam të bëjmë përsëri analizat e ujit, akulloreve dhe ëmbëlsirave. Niko i thotë bashkëbiseduesi "do vini vete apo do ti bëjme siç i kemi bere heren e fundit", ndërsa kjo e fundit pasi merr konfirmimin nga Fatmiri, i thotë personit nën hetim Niko Nika do na i bësh si herën e kaluar analizat, si dhe i dërgon me SMS produktet (uje, akullore, ëmbëlsira), emrin e subjektit Linea

Style Shpk, nipin L41405003J, tre adresat e ushtrimit të aktivitetit Rr. "Siri Kodra", Rr. "Ibrahim Rugova", Rr. "Murat Toptani", emrin e administratorit Glendi Abdi.

Menjëherë me pas, në orën 11:18 personi nën hetim Niko Nika telefonin numrin telefonik celular 0685818935 në posedim nga shtetasi me emrin "Hazis" të cilit i kërkon që kur të shkoj në zyrë të bëj një kërkesë për Fatmirin, pasi ka kërkuar t'ja bëjmë analizat si herën e kaluar. Shtetasi Haziz, merr përsipër të bëj kërkesën.

Në datë 10.06.2020, personi nën hetim telefonon numrin celular 0693030433, që interesohet për analizat e subjektit "Linea Style" Sh.p.k, të cilat i thotë ato janë gati. Bashkëbiseduesja i thotë mund ti lësh tek kasa e Cokolatit, porosi për Fatmirin ose Matildën. Personin nën hetim e pyet: "Pagesat i keni lënë atje", ndërsa bashkëbiseduesja i thotë: "Pa merak, për të ta bërë ata pagesën. Në momentin që ta lësh të thuash detyrimin dhe të ti japin, ti japin te lokali pa merak. Ose me merr kur të jesh atje, flas me lokalin të më thuash detyrimin edhe e rregullojmë". Rezulton që në momentin që personi nën hetim ka shkuar në subjektin "Linea Style" në zonën e ish Bllokut, në orën 04:25 ka telefonuar serish numrin celular 0693030433 (Matilda Hoxha), e cila e pyet i thot atij: "E lajmerova une atë cunin edhe për pagesen ... sa ti detyrohemi te lutem qe ti them unë tani....., sa të detyrohemi që ti them atij cunit për pagesën", ndërsa Niko i thotë: "Po si heren e parë pra e lamë, 30 mijë".

Për të dokumentuar këtë episod të dyshuar korruptiv, shërbimet e policisë gjyqësore kanë administruar ne cilësinë e provës materiale pamjet filmike të datë 10.06.2020, në subjektin tregtar "Linea Style" (Cioccolat-Italiani). Nga këqyrja e pamjeve filmike të marra nga kemara me emertimin "Hyrja" që fokuson pjesën e banakut dhe pjesërisht ambientit e jashtëm rezulton që, në orën 16:30 shfaqet duke hyrë në ambientet e subjektit tregtar të sipërcituar shtetasi Niko Nika, i cili shoqërohet nga një person tjetër i gjinisë mashkull, me flokë të thinjur, i cili mban një çantë (kra-sup). Pasi afrohen tek banaku personi nxjerre nga çanta disa dokumente të futura ne një qese plasmani të tejdukshme, të cilat ja jep personit nën hetim Niko Nika, ndërsa ky i fundit ja jep njërit prej punonjëseve të "Linea Style". Më pas, Niko dhe personi që e shoqëron atë ulën në një nga tavolinat në ambientet e jashtme të lokalit. Në orën 16:33:50 punonjësi drejtohet në tavolinën e tyre, ku nga reflektimi i kanatës së xhamit tejdukshëm të derës që qëndron e hapur dallohet që ai mban në dorë një zarf të vogël me ngjyrë të bardhë. Menjëherë pas këtij momentit, Niko dhe personi që e shoqëron atë largohen duke ikur nga objektivi i kamerës, ndërsa punonjësi i "Linea Style", shikohet duke futur letra e marra nga Niko në sirtaret e banakut.

Rasti i subjektit tregtar E.T i cili ka bar restorant pranë Ministrisë së Shëndetësisë

Në datë 10.06.2020, ora 06:49 MD, personi nën hetim Niko Nika telefonohet nga numri 0686883050 në përdorim nga personi i thërritur Edi, i cili i thotë se numrin ja ka dhënë Arnoldi i Dajtit. Telefonuesi i shpjegon Nikos se ka nje Bar - Restorant afër Ministrisë së Shëndetësisë, dhe ato lënë të takohen për të folur për disa gjëra që kërkohen nga Higjena.

Në datë 11.06.2020, në orën 05:35 MD, personi nën hetim telefonon numrin telefonik celular 0685818935 në posedim nga personi i identifikuar me emrin Hazis, të cilit i shpjegon lidhur me bisedën e bërë me personin e thërritur Edi (emri i tij del nga konteksti), i cili kërkon të bëj analizat e ujit, si dhe dezinfektimin e Restorantit tek Zëri i Popullit. Personin nën hetim i referon shtetasit Hazis që persona të tjerë i kanë kërkuar subjektit 500 mijë lekë për dezinfektimin por

Eda: Jo, ja tregoj une ty, si u bë sot

Niko: Nuk du unë, unë e kam per ty hallin, ta them si gocën time

Eda: Po pra po, edhe sot domethen ato vet, po doli siç me the ti domethon

Niko: Po, po

unë i thash do ta rregullojmë me 250 mijë lekë të vjetra. Të dy bashkëbiseduesit bien dakord për këtë shifër. Me pas, personin nën hetim kontakton serish me personin e identifikuar me emrin EDI (0686883050), të cilit i thotë fola me atë djalin (nënkupton Hazizin), ke ai çmimin rrotullohet, ndërsa subjekti i interesuari i konfirmon që është dakord.

Në datë 13.06.2020, ora 07:24 MD, personi nën hetim Niko Nika telefonon personin me emrin Hazis (0685818935) dhe diskutojmë për çmimin e dezinfektimit të subjektit të sipërcituar, dhe përmbajta e bisedës se zhvilluar me tyre është si më poshtë vijon:

Niko: Në po i themi 200 -in ...190 -të

Hazisi: I japim ja 20 mijë lekë, ja 15 mijë lekë atij Ladit, t'ja hedhim një pombë kshu

Niko: Po një pombë me ja bo, t'jap dokumentin thuj, menoje - menoje ti deri të hënën që do ikim neve

Hazisi: Po po ja 15 - 20 mijë lekë ja japim Ladit dhe mirupafshim, të tjerat i ndajmë ne

Niko: Po po, 250 mije ja kursyme nga kjo, dhe 150 nga ky, 400 mijë lekë ku ti gjej ai

Hazisi: Mir thuaj

Në datë 15.06.2020, ora 09:43 personi nën hetim Niko Nika telefonon serisht personin me emrin Edi (0686883050) të cilit i thotë: "Atë ujin do dergosh njeri ta bësh, apo tja jap no njërit ta bëj", ndërsa personi me emrin Edi i thotë: "Kryeje vete se rregullona mbasdite bashkë o burre". Gjithashtu Niko i thotë bashkëbiseduesit: "Edhe punen e dizinfektimit e kane rregulluar ata, me gjysmen e atij çmimit afërsisht"

Nga operatori i telefonise celulare "Telecom Albania" është konfirmuar që numri telefonik celular 0686883050 figuron i rregjistruar në emër te shtetasit Edmond Terthorja.

Rasti i subjektit tregtar "Martini" sh.p.k

Në datë 15.06.2020, ora 07:59, personi nën hetim Niko Nika telefonohet nga shtetasja Eda Myftari (0693640745) dhe gjate bisedës Niko e pyet atë: "Si dole në dreke aty ku vajte"? Eda i thotë: "Shume mir, siç me kishte thone ti... Ej, te tregoj nesër, se me pa Abikela tek kasa, aty poshtë. Me tha mu cne ti po e ben pagesen vet. I thash une po s' ishte pronari i subjektit, ishte me Vlorë dhe me kerkoi si nder. Nuk lejohet tha". Në vijim të këtij komunikimi personi nën hetim Niko Nika i shpjegon shtetasës Eda itinerarin e lëvizjes që ato do ndjekin së bashku me Hazisin ditën pasardhëse, dhe përmbajta e bisedës së zhvilluar mes tyre është si më poshtë vijon:

Niko: Zakonisht, kjo ktu që do shkojme në nesër

Eda: Martini

Niko: Martini, jep na gjo të vogël, jep të treve nga 20 -tshë, kshu ka pas dhonë

Eda: Okej

Niko: Bereqaves

Eda: Po normale

Niko: Edhe naj embersire e merr aty po deshe ti, se une nuk dua

Eda: Mir doku, rrofsh

Niko: Avash avash mos u bë tamaqare

Eda: Jo, sic me ke thene ti

Niko: Edhe kshu ca te doj vet, të thot vet

Eda: Jo, ja tregoj une ty, si u bë sot
Niko: Nuk du unë, unë e kam për ty hallin, ta them si gocën time
Eda: Po pra po, edhe sot domethen ato vet, po doli siç me the ti domethon
Niko: Po, po
Eda: -Hajde pra flasim
Niko: Sa të rrije kot aty, ike bere një punë, edhe atë i ndihmove njëçik, datën 4 të muajit
Eda: Po, ashu është


Në datë 16.06.2020, ora 09:25 PD, personi nën hetim Niko Nika telefonon personin me emrin Gjergji (0692969301) të cilin e vë në dijeni se po nisen për kontroll, si dhe i kërkon që të rregulloj/pastroj ambientin.

Personi nën hetim është mbajtur në vëzhgim në datë 16.06.2020, nga ku është konstatuar që në orën 09:20 ai del nga Instituti i Higjienës, hipën në mjetin "Fiat" me traga AA548SF (në pronësi të shtetases Eda Myftari) dhe lëvizin duke dalë në Bulevardin "Bajram Curri" dhe ndaluar afër akullore Martini. Në orën 09:30 shtetasi Niko Nika zbret nga mjete AA548SF së bashku me një person të seksit mashkull të moshës rreth 55 vjeç (Haziz Lura) si dhe një person të seksit femër të seksit femër (Eda Myftari) dhe të tre së bashku futen në ambientet e dyqanit. Në orën 10:06 të tre personat e sipërcituar dalin nga ambientet e dyqanit, hipin në mjetin me traga AA548SF dhe lëvizin në drejtim të rrugës së Elbasanit.

Organizim kontrolli tek një subjekt tregtar me qëllim përftimin material

Gjithashtu, nga përgjimet telefonike rezultoi që në datë 02.07.2020, personin nën hetim Niko Nika së bashku me kolegun e tij kanë ushtruar kontroll tek një subjekt në lagjen Komuna e Parisit, Tiranë. Kështu, në lidhje me këtë episod në orën 11:32 PD, personi nën hetim Eda Myftari telefonohet nga numri telefonik celular 0685028489 i identifikuar me emrin Rita, motra e Ladit. Bashkëbiseduesja i referon personit nën hetim Eda Myftari që në subjektin saj kanë ardhur për kontroll dy persona, të cilët i kanë nxjerre probleme për produktin e kripës së zezë. Personin nën hetim Eda Myftari i thotë shtetases me emrin Rita, do të shoh kush e mbulon zonen aty dhe do flas me ta. Menjëherë me pas, personin nën hetim Eda Myftari telefonon personin tjetër nën hetim Niko Nika, dhe ky i fundit për të kamufluar veprimet e tij e thërret asaj me emrin "Beni". Me pas, personin nën hetim Eda Myftari telefonon subjektin me emrin Rita, të cilët i referon që foli me njerin prej tyre, kripa nuk lejohet që të tregtohet, por ata nuk do mbajnë procesverbal. Shtetasja Rita, e pyet personin nën hetim Eda si të veprojnë, ndërsa kjo e fundit i sugjeron ti lerë ndonjë "kafe" të dyve, nga 50 - të secilit.

Me pas, personi nën hetim Eda Myftari vijon komunikimin nga i njëjti numër celular me shtetasen e identifikuar me emrin "Marsela", nusja e Ladit, të cilës i parashtron se ata janë dy koleget e saj, ka folur me Ritën që t'ju lerë një "kafe" dhe të rregullohen. Në orën 11:37 personi nën hetim Eda Myftari telefonon personin tjetër nën hetim Niko Nika, të cilit me të shaka i thotë mua mos me thirr më "Beni", më bëj një zile kur të mbaroni. Ndërsa në orën 11:37 personin nën hetim Eda Myftari telefonohet nga numrin telefonik celular 0682597257, identifikuar me emrin "Marsela" e cila i thotë se ata s'pranojnë gjë, ndërsa Eda i thotë "... thuaj Ritës mos t'jua fus në xhep, t'jua fusë në një vend ke dosja, ku ta dine unë ...". Gjithashtu, shtetasja Eda i thotë bashkëbisedueses Marsela se ajo ndodhet në Selite, por po kthehet dhe po



Më datë 14.06.2020, ora 06:15 MD, shtetasja ...
nen hetim Niko Nika (0692071544) të cilit i thotë: "Jam ne ...
"negjitet, me vullë", personi nën hetim Niko Nika i thotë: "... më tha ...
"ta lej ne dorën e vet ... dhe të vij në nesër ai ta marrë, pimë një ...
shtetasja Eda pranon ofertën/premtimin duke u shprehur:

shtetasin Ihsan Ihsani

shkon edhe ajo vetë atje. Menjëherë me pas personi nën hetim Eda Myftari i dërgon një sms personit tjetër nën hetim Niko Nika me tekst: "të vijn unë", ndërsa ky i fundin e telefonit dhe i thotë: "mos hajde, se ç'ka fut një gjo ke xhepi, t'shofim".

B. III. Njëpërmjet ndërmjetësimit për të bërë të mundur kryerjen e tamponëve Covid-19 jashtë procedurës normale për persona të ndryshëm, kundrejt përfitimit material.

Në këtë veprimtari janë të përfshirë personat nën hetim Niko Nika, Eda Myftari dhe subjekte që kërkojnë kryerjen e tamponëve.

Në bisedat e zhvilluar në datën 12.6.2020 e në vazhdim rezultojnë biseda me interes sipas të cilat personi nën hetim Ihsan Hasani ka ndërhyrë njëpërmjet Nikos dhe ky i fundit tek Eda, me qëllim për të kryer tamponin Covid-19 të dy personave kundrejt përfitimeve materiale. Në datë 12.06.2020, ora 08:25 MD, personi nën hetim telefonon numrin 0693346871, i identifikuar gjate hetimit me emrin Ihsan Ihsani, të cilit interesohet për bërjen e tamponit për persona të tretë, me ndërmjetësimin e Nikos tek personeli mjekësor. Në datë 13.06.2020, ora 09:14 personi nën hetim Niko Nika telefonohet nga shtetasja Ihsan Ihsani (0693346871) dhe përmbajta e bisedës se zhvilluar mes tyre është si me poshtë vijon:

692071544 (Niko): Po ja morën

693346871 (Ihsani): Po shumë bukur, me thane mua ata, tashti me thuaj për të gjitha ca detyrohem, kur do marrin ata

692071544 (Niko): Tani une nuk e di, i thash qysh dje une e kam shok të ngushtë

693346871 (Ihsani): Pyete mor vëlla, ska naj gjo

692071544 (Niko): Se i thash, tani e takova ate unë, e takova rastesisht tani, biles me bëri ndere me solli me makine deri tek shtepia se lash makinën per servis

693346871 (Ihsani): Bravo, thuaj sa i detyrohem ?

692071544 (Niko): Tani po e marrin me tha mu, i thash une letrën, se letra na duhet nuk na duhen keta te tjerat. Letra tha me prit ata, duhet dy jave, po do mundohem ta marrim te henen neve.

693346871 (Ihsani): Me thuaj sa te detyrohem ?

692071544 (Niko): Ore do marrim letren njiher, pastaj do i them une ... qenkan shoke te ngushte

693346871 (Ihsani): Jo mos i thuaj fare, le te paguajne o vëlla, cke ti se kan ata mos caj byth, hajt se i mbyll rrugen vetes pasaj per here tjeter.

692071544 (Niko): Jo me jo po hë, ... mir mir hë se flasim prap.

693346871 (Ihsani): Më dëgjo mua se nuk jane keq për pare

692071544 (Niko): Flasim më, dakort po hë

693346871 (Ihsani): Hajde zemer, shëndet

Gjithashtu Niko e pyet bashkëbiseduesen Eda: "Si dolën përgjigjet e atyre dyve", ndërsa kjo e fundit përgjigjet "Negativ, po se sot erdhën dy me zarf po ishin të përdjeshmet, nesër i marr me zarf të tuat dhe ja japim". Në vijim të këtij komunikimi Niko i thot Edes "me tha mua sa i detyrohem ? (nënkuptohet Ihsan Ihsani), i thash unë do flasim kur të kemi letrat në dorë". Eda i thotë "Okej, kur të marr unë zarfin në dorë".

Më datë 14.06.2020, ora 06:15 MD, shtetasja Eda Myftari (0693640745) ka telefonuar personin nen hetim Niko Nika (0692071544) të cilit i thotë: "Jam ne Institut sapo e mora zarfin me ato dy përgjigjet, me vulë", personi nen hetim Niko Nika i thotë: "... më tha mua ky shoku im ... sa e doni kafen?... a t'ja lej ne dorën e vet ... dhe të vijn nesër ai ta marri, pimë një kafe më atë shokun tim, e ta marri", ndërsa shtetasja Eda pranon ofertën/premtimin duke u shprehur: "Okej në rregull".

Menjëherë më pas, në orën 06:16 MD, personin nen hetim telefonon shtetasin Ihsan Ihsani (693346871) dhe përmbajta e bisedës së zhvilluar mes tyre është si më poshtë:

692071544 (Niko): Mir, nigjo e ka mbaru ajo atë punën

693346871 (Ihsani): Po, kur do vij ti mor unë dhe ca të detyrohem ?

692071544 (Niko): Tani detyrimin leja ne dore të vet, sa të duan ti japin asaj goces

693346871 (Ihsani): Po sa duhet me i dhonë ?

692071544 (Niko): Ku di gjo unë, nuk e di fare

693346871 (Ihsani): Afërsisht o burrë i thuaj, se ata do më pysin mu

692071544 (Niko): Po mira pra, unë i thash e kam shokë të ngushtë, unë nuk i marr gjo atij

693346871 (Ihsani): Jo mor vëlla mos thuj, të thash 500 herë, çke ti

692071544 (Niko): Ti thuaj sa duan ata

693346871 (Ihsani): Po mir afërsisht sa ? 20 a, 30 a,

692071544 (Niko): Nuk e di... dëgjo Nikon hajde neser mjes ti, me bej një telefon mu poshte, te vij unë me atë gocën pimë një kafe

693346871 (Ihsani): Të vij unë atje

692071544 (Niko): E mo hajde neser qe ta moresh

693346871 (Ihsani): Ca ore ?

692071544 (Niko): Hajde në tetë e gjysem ti

693346871 (Ihsani): Në tetë e gjysem me ke aty. Edhe ti them unë sa, apo tij lej naj 20-tshe, 40-tshe ?

692071544 (Niko): E me mo, futja ne një copë letër ti, edhe leja, merr një gjo per cunin thuaj, se me tha Niko ke një cun thuaj

693346871 (Ihsani): Atehere 10 -të për koke apo 20 -të për koke

692071544 (Niko): Po ku di gjo, ato jane dy gra, boj me një 30-tëshe

693346871 (Ihsani): 15-të njona, 15-të tjetra

692071544 (Niko): Eme, një 30-tëshe, them unë, ku di gjo unë

693346871 (Ihsani): Në rregull, mir shpirt

692071544 (Niko): Me bëj një telefon kur te nises, se kush e di naj mbejdhe naj gjo

Në datë 18.06.2020, ora 06:14 personi nen hetim Niko Nika telefonohet nga personi që disponon numrin telefonik celular 0697075375 identifikuar gjatë hetimit me emrin "Genti" (regjistruar në emër të shtetasit Gentian Qesku), i cili i thotë: "Niko si kalove, me dogjo se e kam urgjente ... Nuk e di akoma kush është personi, me duhet për një person me bo tampon me çdo lloj shifre të mundshme, e du urgjet ... Le të kërkoj ca te doj, me thuaj ca do, na ja ku i ke, ti coj personin dhe ta kryj. Si i bohet ? ndërsa Niko i thotë: "Ja të flas me një matrapaze që kena aty". Menjëherë me pas personi nen hetim Niko Nika telefonin shtetasen Eda Myftari (693640745) të ciles i thotë: "Degjo, me bo një tampon me pagesë, e bejmë dot neser, dhe sa ti them, një person". Pas insistimit të shtetasit Niko, shtetasja Eda i thote: "Po bëhet pra, se ti e di shumë mir që bëhet, ca më pyet kot ... ik tani flasim nesër".

Më pas, presioni që posedon numrin telefonik celular 0697075375 i dërgon me SMS personit nën hetim Niko Nika (0692071544) gjeneralitetet e plota të shtetasës që ti merret tamponi (me initiale "E.T"), numri e saj i telefonit si dhe adresën e sakte të banimit. Menjëherë më pas personi nën hetim Niko Nika telefonon serisht telefonik celular (0697075375) dhe përmbajtja e bisedës së transkriptuar mes tyre është si më poshtë:

692071544: *Po është sëmure kjo ? apo kshu kot*

697075375: *Nuk e njof, nuk e di, ta shpjegoj kur të takohemi gojarisht*

692071544: *Po kjo e di për pagesat, për gjonat, se mos ti nxjerri naj llaf*

697075375: *S'ke pune me atë fare, punen i maroj unë të gjitha, ja maroj unë këtyre mo vëlla, ke pune vetem me mu me këtë pjese, ske pune me atë fare, punën e kryej unë*

Në komunikimin e datës 19.06.2020, ora 09:37, shtetasja Eda Myftari i referon personit nën hetim Niko Nika, që kam qene duke bërë hetim (epidemiologjik), sapo mora Enedën. Këtë fakt personin nën hetim ja referon me pas personit të interesuar me emrin "Genti" që disponon numrin telefonik celular 0697075375.

Në datë 19.06.2020, ora 01:57 personi nën hetim Niko Nika telefonohet nga shtetasja Eda Myftari (0693640745) dhe përmbajtja e bisedave të zhvilluar mes tyre është si më poshtë:

(Niko): *Ej nuk me njoftove për atë, ca bërë për atë, dhe smë the sa ti them atij unë ?*

(Eda): *Sa të dush ti, ti e di. Unë të thash sa të dush*

(Niko): *Mir dakort. Tani, ja moren apo sa moren ?*

(Eda): *Po ja kam dhënë grupit, besoj se kane vajt ja kanë marrë. Gjithsesi të marr të telefon*

(Niko): *Po grupi kujt është ?*

(Eda): *Nji minut ... (pazuz) dok me dëgjon ?*

(Niko): *Po, kujt grupi ja ke dhonë ?*

(Eda): *Të REXHEPIT*

(Niko): *Mir, me njofto ë, duhet me e njoftu atë, që të ashtu*

(Eda): *Mir ja se të njoftoj unë, po besoj se tani ne nji e gjysëm do ja merrnin asaj (Niko): E mir dakort, me njofto ë*

Nga përmbajtja e transkripteve të bisedave telefonike rezulton që personi nën hetim Niko Nika i kërkon shtetasës Eda Myftari ta njoftojnë në cdo kohë për rezultatet e analizave, të cilat rezultojnë të kenë dalë Negativ.

c) Rasti i shtetasit L. G, i cili ndërhyr për t' iu bërë tamponin dy shtetasve rus që kanë ngelur në Shqipëri, duke mos pas mundësi për t'u larguar.

Gjithashtu, në datë 23.6.2020, ora 02:50 MD, personi nën hetim Niko Nika telefonohet nga numrin telefonik celular 0692020315, identifikuar me emrin Luan, i cili i thotë se dy shtetas të huaj që kane ardhur për turizëm në vendin tonë, kane ngelur këtu, por autoriteti në kufi i kërkojnë bërjen e tamponit për ti lejuar të largohen. Personin nën hetim Niko Nika i referon shtetasit Luan se shteti ka vene nje çmimin prej 55 euro për person, por marrja e taponimit mund të bëhet dhe në rrugë private dhe merr përsipër të kontaktojnë me një person tjetër, e cila rezulton të jetë shtetasja Eda Myftari.

Në orën 03:01 personin nën hetim Niko Nika telefonon serisht shtetasin Luan të cilit i thotë: *"fola unë me një këtu, me dash me i bo shku duhet me ardh këtu me fol me keto këtu, te morin emrat shënim etjer – etjer. Rruga zyrtare. Rruga private tha kjo me nga pesëdhjetë mijë lekë secili, dy veta herë pesëdhjetë, njëqind"*. Shtetasi Luan pranon këtë opsion, ato bien dakort për mënyrën e të vepruarit (modus operandi) dhe përfundimisht shtetasin Luan i thotë personit nën hetim Niko Nika: *"Unë do ta bej njëqind e pesëdhjetë mijë leke për këta të dy"*, kjo në shenjë mirënjohje për ndihmen që ky i fundit po i jep. Në vijim personi nën hetim Niko Nika i jep shtetasit Luan, numrin e shtetases Eda Myftari (0693640745) dhe e orienton që të dhënat/gjeneralitet e dy shtetaseve të huaj ti nise me ehat's app tek ky numër. Për këtë fakt personi nën hetim komunikon paraprakisht edhe me person tjetër nën hetim Eda Myftari. Në orën 03:27 kundrejt numrit 0692071544 në posedim nga personi nën hetim Niko Nika është dërguar SMS nga numri telefonik celular 0692020315, në posedim nga shtetasi me emrin Luan, me tekst: *"Përshmetje Z. Eda jam miku i Dr Niko.... " ku jep emrat e dy personave që kërkohet tui bëhet tamponi ndërsa menjëherë me pas shtetasi Luan i konfirmon personit nën hetim me SMS dergimin e të dhënave.*

Në vijim të komunikimit mes tyre të datës 24.06.2020, shtetasi me emrin Luan, i thotë personit nën hetim Niko Nika: *"Tashi "kafen" do ta jap ty unë"*, ndërsa ky i fundit i thotë: *"Po po, se do t'ja jap asaj gocës unë ... ske punë ti fare, kur të sjell letrat unë ke pune ti. Letrat do ti sjell unë"*.

Personi nën hetimi Niko Nika pasi ka komunikuar paraprakisht me shtetasen Eda Myftari, në datë 25.06.2020, ora 09:09, telefon shtetasin me emrin Luan të cilit i thotë: *"Luani, ajo vajza do vej ti marri pak me vonë, se si kan bo gati ato, po unë nga ora 11 e mbrapa do lëviz, nuk do jem këtu. Edhe ka mundësi me që të duhen ty urgjente, mund të ti sjelli ajo. Shtetasi Luan i thotë të mi sjelli tek lokali, ndërsa Niko i thotë: "Po, do i them une ... tani kur të vij aty ajo, futja me një zarf ato dy pesëdhjetëshet dhe jepja. Shtetasi Luan përmend shifrën 150 -të, Niko i thotë: "2 pesëdhjeteshe jepi asaj, ske punë më tjetër, ndërsa Luani shprehet se ajo tjetra është e jotja, duke nënkuptuar 50 -të mijë lekë të vjetra.*

Në datë 25.06.2020, ora 05:55 MD, personin nën hetim Eda Myftari (0693640745) telefonon numëron telefonik 0689000770, në posedim nga mjeku i identifikuar me emrin Rexhep, i cili e informon atë se kane dale përgjigjet për dy shtetasit e huaj. Menjëherë me pas personi nën hetim Eda Myftari telefonon personin tjetër nën hetim Niko Nika te cilin e informon që përgjigjet kane dalë, por ka shkuar ti tërheq Rexhepi dhe do t'ja jap direkt atij robit tend (nënkuptohet shtetasi Luan). Shtetasja Eda, i thote shtetasit Niko *"Thuaj atij robit të sqarohet me ty jo me atë, ... "peshkun" do e marrësh ti nesër"*.

Nga hetimi rezulton se për të siguruar "eksluzivitetin" e përgjigjes se analizave të tamponit për dy shtetasit e huaj, që ka si synim fundor atë të përfitimit të parregullt të vlerave monetare, personi nën hetim Niko Nika ka mbajtur kontakte të vazhdueshme me shtetasin Luan, ndërsa personi nën hetim Eda Myftari ka mbajtur kontakte te vazhdueshme me mjekun me emrin Rexhep. Njëkohësisht ata (Eda dhe Niko) kanë komunikuar dhe rakorduar me njeri – tjetrin, me qëllimin final marrjen e përfitimit të parregullt. Me konkretisht, një pjese e përmbajtjes se bisedës se datës 25.06.2020, ora 06:08 të zhvilluar mes tyre është si më poshtë vijon:


personale ndaluese "pezullimit të ushtrimit të detyrës apo shërbimit publik" parashikuar nga neni 240/1 germa "a" i Kodit të Procedurës Penale.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata bazuar në nenet 228, 229, 244, 245, e vijues të Kodit të Procedurës Penale

VENDOSI

1. Caktimin e masës së sigurimit personal atë të "Arrestit në Burg" parashikuar nga neni 238 i Kodit Penal ndaj personit nën hetim **Niko Nika**, i biri i Vasil-it dhe i Vasiliqi-s i datëlindjes 18.05.1955, lindur në Korçë dhe banues në Tiranë, me adresë banimi rruga "Elbasanit", pallati "Klasik", Njësia Bashkiake Nr.2 Tiranë, me arsim të lartë, me gjendje civile i martuar, me kombësi e shtetësi Shqiptare, i dyshuar për kryerjen e veprës penale "Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike" më shumë se njëherë dhe kryer në bashkëpunim, "Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike", të kryer më shumë se një herë, dhe "Falsifikim i dokumentave parashikuara nga nenet 259, 245/1//2 dhe 186 i Kodit Penal.
2. Caktimin e masës së sigurimit personal atë të "Arrestit në shtëpi" parashikuar nga neni 237 i Kodit Penal ndaj personit nën hetim **Eda Myftari**, e bija e Hyseni-t dhe e Eliverta e datëlindjes 07.01.1991, lindur në Erseke dhe banuese në Tiranë, me adresë banimi sipas RGJC Selitë, Lagja nr 13, Rr. "Kodra Diellit", me arsim të lartë, me gjendje civile i martuar, me kombësi e shtetësi Shqiptare, e dyshuar për kryerjen e veprës penale "Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike" më shumë se njëherë dhe kryer në bashkëpunim, "Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike", të kryer më shumë se një herë, parashikuara nga nenet 259 e 25 dhe 245/1 i Kodit Penal.
3. Caktimin e masës së sigurimit personal atë të "Arrestit në Burg" parashikuar nga neni 238 i Kodit Penal ndaj personit nën hetim **Hazis Lura**, i biri i Halil-it dhe i Xhile-s, i datëlindjes 23.01.1968, lindur në Kishavec/Kukës dhe banues në Paskuqan, lagjia "Kodër e Kuqe", banese private, më arsim të lartë, me gjendje civile i martuar, me kombësi e shtetësi Shqiptare, i dyshuar për kryerjen e veprës penale "Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike" kryer më shumë se njëherë dhe në bashkëpunim dhe "Falsifikim i dokumenteve", parashikuara nga nenet 259 e 25 dhe 186 të Kodit Penal.
4. Caktimin e masës së sigurimit personal atë të "Arrestit në shtëpi" "Arrestit në shtëpi" parashikuar nga neni 237 i Kodit Penal ndaj personit nën hetim **Ihsan Ihsani**, i biri i Tajar-it dhe i Mynevere, i datëlindjes 29.12.1953, lindur dhe banues në Tiranë, më adresë banimi sipas RGJC Njësia Bashkiake nr. 9, Rr. "Kongresi Permetit" me arsim të lartë, me gjendje civile i martuar, me kombësi e shtetësi Shqiptare, i dyshuar për kryerjen e veprës penale "Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike" kryer më shumë se njëherë parashikuara nga neni 245/1 të Kodit Penal.
5. Caktimin e masës së sigurimit personal atë të "Arrestit në shtëpi" parashikuar nga neni 237 i Kodit Penal ndaj personit nën hetim **Ilir Hoxha**, i biri i Kamber-it dhe i Farushe-s, i datëlindjes 31.03.1970, lindur në Elbasan dhe banuese në Tiranë, me adresë banimi sipas RGJC Njësia Bashkiake nr. 3, Rr. "Ali Baushi", me arsim të lartë, me gjendje civile i martuar, me kombësi e shtetësi Shqiptare, i dyshuar për kryerjen e veprës penale



“Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike”, “Falsifikim i dokumenteve Shëndetësore” parashikuara nga nenet 259 dhe 186 të Kodit Penal.

6. Caktimin e masës së sigurimit personal atë të “Arrestit në Shtëpie” parashikuar nga neni 237 i Kodit Penal parashikuar nga neni 237 i Kodit të Procedurës Penale ndaj personit nën hetim **Franc Daija**, i biri i Kolë-s dhe i Shpresa, datëlindjes 13.06.1955, lindur dhe banues në Tiranë, me adrese banimi sipas RGJC Njësia Bashkiake nr 5, Rr. “Sh Dishnica” Nr. 84, me gjendje civile i martuar, me arsim të lartë, me kombësi e shtetësi Shqiptare, i dyshuar për kryerjen e veprës penale *“Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike”* të kryer më shumë se njëherë dhe në bashkëpunim dhe *“Falsifikim i dokumenteve Shëndetësore”* parashikuar nga nenet 259 e 25, dhe 188/2 të Kodit Penal.
7. Caktimin e masës së sigurimit personal atë të “Arrestit në Shtëpie” parashikuar nga neni 237 i Kodit të Procedurës Penale ndaj personit nën hetim **Ornela Balla**: e bija e Xhevatit dhe e Bahrijes, e datëlindjes 19.06.1986, lindur në Lushnjë dhe banuese në Tiranë banuese në Komuna e Parisit, Pallati “Pastareli”; e dyshuar për kryerjen e veprës penale *“Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike”* parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal.
8. Caktimin e masës së sigurimit personal atë të “Arrestit në Shtëpie” parashikuar nga neni 237 i Kodit të Procedurës Penale ndaj personit nën hetim **Evald Bejaj**: i biri i Kujtim dhe Bukuroshe, i datëlindjes 19.05.1990, lindur në Vlorë dhe banues në Tiranë, rruga “Sami Frashëri” P.10-1-5, I dyshuar për kryerjen e veprës penale “Shpërdorim detyre” parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal.
9. Caktimin e masës së sigurimit personal shtrëngues atë të “Arrestit në shtëpi” parashikuar nga neni 237 i Kodit të Procedurës Penale ndaj personit nën hetim **Johana Sinani**: e bija Ismailit dhe e Renatës, e datëlindjes 29.07.1991, lindur në Delvinë Sarandë dhe banuese në banuese në Komuna e Parisit, pallati përballë “Trend Caffë”; (verifikuar fizikisht pallati ku banon), e dyshuar për kryerjen e veprës penale *“Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike”* parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal.
10. Caktimin e masës së sigurimit personal shtrëngues atë të “Arrest në shtëpi” parashikuar nga neni 237 i Kodit të Procedurës Penale ndaj personit nën hetim **Arjan Gjoka**: i biri i Sadedin dhe Ruhije, i datëlindjes 25.05.1963, lindur dhe banues në Tiranë, Rruga Njësia bashkiake nr. 9, Mine Peza/196/2/16/1, i dyshuar për kryerjen e veprës penale “Shpërdorim detyre” parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal.
11. Caktimin e masës së sigurimit personal atë të “Arrestit në Shtëpie” parashikuar nga neni 237 i Kodit të Procedurës Penale ndaj personit nën hetim **Anda Muçaj**: e bija e Bujarit dhe e Mimosës, e datëlindjes 24.10.1988, lindur në Tiranë dhe banuese në Tiranë, Njësia bashkiake nr. 5, Brigada 8 Kati2 Ap9/017/-, e dyshuar për kryerjen e veprës penale *“Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike”* parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal.
12. Caktimin e masës së sigurimit personal atë të “Pezullimit të ushtrimit të detyrës apo shërbimit publik” parashikuar nga neni 240/1 germa “a” të Kodit të Procedurës Penale ndaj personit nën hetim **Luiza Metani (Goduni)**, e bija e Irfani-t dhe e Tanije-s, e datëlindjes 13.06.1972, lindur në Poliçan dhe banuese në Tiranë, më adresë banimi sipas RGJC Njësia Bashkiake nr. 7, Rr. “Artan Lenja” nr. 31, me gjendje civile i divorcuar, me arsim të lartë, me kombësi e shtetësi Shqiptare, e punësuar pranë Poliklinikës nr. 6 Tiranë e dyshuar për kryerjen e veprës penale *“Falsifikim i dokumenteve Shëndetësore”* parashikuara nga neni 188/2 të Kodit Penal.

13. Caktimin e masës së sigurimit personal ndalues atë të "Pezullimit të ushtrimit të detyrës apo shërbimit publik" parashikuar nga neni 240/1 germa "a" të Kodit të Procedurës Penale ndaj personit nën hetim **Diana Hysi**, e bija e Petraq dhe Kontesh, e datëlindjes 17.01.1969, lindur në Berat dhe banuese në Tiranë, me adrese banimi sipas RGJC Njesia Bashkiake nr. 7, "Sali Butka", me gjendje civile e martuar, me arsim të lartë, me kombësi e shtetësi Shqiptare, e punësuar pranë Poliklinikës nr. 1 Tiranë e dyshuar për kryerjen e veprës penale "Falsifikim i dokumenteve Shëndetësore" parashikuara nga nenet 188/2 të Kodit Penal.

14. Caktimin e masës së sigurimit personal ndalues atë "Pezullimit të ushtrimit të detyrës apo shërbimit publik" parashikuar nga neni 240/1 germa "a" të Kodit të Procedurës Penale ndaj personit nën hetim **Marinela Sulmina (Hysa)**, e bija e Shefqet-it dhe e Nexhmije-s, e datëlindjes 03.07.1978, lindur në Durrës dhe banuese në Tiranë, me adresë banimi sipas RGJC Njesia Bashkiake nr. 1, Rr. "Lili Tafaj", me gjendje civile e martuar, me arsim të lartë, me kombësi e shtetësi Shqiptare, e punësuar pranë Poliklinikës nr. 4 Tiranë e dyshuar për kryerjen e veprës penale "Falsifikim i dokumenteve Shëndetësore", parashikuara nga neni 188/2 të Kodit Penal.

Urdhërohet Policia Gjyqësore në varësi të Prokurorisë "Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar" Tiranë, për zbatimin e masës së sigurimit të caktuar në këtë vendim dhe njoftimin e menjëhershëm të Gjykatës së Shkallës së Parë "Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar" Tiranë për ekzekutimin e këtij vendimi.

U shpall në Tiranë, sot më datë 15. 07. 2020, ora 13. 30.

SEKRETARE


NESILA XHEMALI



GJYQITAR


KLODIAN KURUSHI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA E POSAÇME KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR
TIRANË

PROCES - VERBAL

Mbi ekzekutimin e Vendimit Penal nr.79, datë 15.07.2020 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar Tiranë, për caktimin e masës së sigurimit personal ndaj personit nën hetim
Evald Kujtim Bejaj

Në Tiranë, viti 2020, muaji Korrik, datë 16, ora 16:30.

Unë Alban Kalaja, Oficer i Policisë Gjyqësore pranë Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë, përpiloi këtë procesverbal për ekzekutimin e Vendimit Penal nr.79 datë 15.07.2020 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar Tiranë, për caktimin e masës së sigurimit personal për personin nën hetim **Evald Kujtim Bejaj**, si më poshtë vijon :

Gjykata e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar Tiranë, me Vendimin Penal nr.79 datë 15.07.2020, ka caktuar masë sigurimi "arrest në shtëpi" ndaj personit nën hetim **Evald Kujtim Bejaj**, për veprën penale "Shpërdorim detyre", parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal.

Përsa më sipër, bazuar në nenin 234 të Kodit të Procedurës Penale, bëj ekzekutimin e Vendimit nr.79 datë 15.07.2020 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar Tiranë, e cila ka caktuar masë sigurimi personal "arrest në shtëpi" ndaj personit nën hetim **Evald Bejaj**, i biri i Kujtim dhe i Bukuroshe, i datëlindjes 19.05.1990, lindur në Vlorë dhe banues në Tiranë, rruga "Andon Zako Çajupi", pallati perballe supermarket "Conad", identifikuar me kartë identiteti me nr.personal "J00519069D".

Me Vendimin penal nr.79, datë 15.07.2020 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar Tiranë, u njoh personi nën hetim Evald Kujtim Bejaj, të cilit iu la një kopje e vendimit të gjykatës.

Procesverwali i mësipërm përpilohet në dy kopje, njëra prej të cilave dërgohet në Prokurorinë e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar për t'iu bashkangjitur dosjes penale, ndërsa një kopje i jepet personit nën hetim ndaj të cilit u ekzekutua vendimi i gjykatës.

Procesverbali pasi lexohet gjendet i rregullt dhe firmoset pa vërejtje.

PERSONI NËN HETIM

Evald Bejaj

PREZENT
AVOKATI MBROJTËS

Luan Ndregjoni

OFICERI I POLICISË GJYQËSORE
ALBAN KALAJA

Alban Kalaja



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA E POSAÇME KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR
TIRANË

PROCES - VERBAL
PËR SEKUESTRIMIN E PROVËS MATERIALE

Në Tiranë, viti 2020, muaji Korrik, datë 16.

Unë Alban Kalaja, Oficer i Policisë Gjyqësore në Seksionin për Hetimin e Korrupsionit pranë Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë, për nevoja hetimi të Procedimit Penal Nr.61/2020 të Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, përpiloj këtë procesverbal mbi sekuestrimin e provave materiale, si më poshtë vijon :

Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar ka regjistruar Procedimin Penal Nr.61/2020, për veprat penale “Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike”; “Ushtrim ndikimi i paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike” dhe “Falsifikimi i dokumentave”, parashikuar nga nenet 259, 245/1 dhe 186 të Kodit Penal.

Gjykata e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar Tiranë, me Vendimin Penal nr.79 datë 15.07.2020, ka caktuar masë sigurimi “arrest në shtëpi” ndaj personit nën hetim Ewald Kujtim Bejaj, për veprën penale “Shpërdorim detyre”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal.

Gjatë kontrollit personal të shtetasit Ewald Kujtim Bejaj, iu gjet dhe fiksua në cilësinë e provës materiale sendet si më poshtë vijon :

- 1 - Një aparat celulari i markës “I-Phone” model 11 Promax, me ngjyrë të zezë, me kamer, me nr.IMEI “353909103448168”, brenda të cilit ka një kartë SIM të Kompanisë Vodafone me nr.cel.”0692521112”. Celulari është i fikur. Ka kod bllokimi “111222”. Nuk ka kod PIN karte.
- 2 - Nje tablet i markes “Lenovo”, me nr.IMEI “866991032849617” dhe “866991032879614”, me kod hapje “4991”. Tableti është i fikur.
- 3 - Kerkese e subjektit Martin Prenga protokolluar tek ISHSH me nr.853 prot, date 18.05.2020, se bashku me vetdeklarimin, fotokopje license, fotokopje pasaporte.
- 4 - Kerkese e subjektit Esmeralda Kaçi protokolluar tek ISHSH me nr.852 prot, date 18.05.2020, se bashku me vetdeklarimin, fotokopje certifikate regjistrimi, fotokopje pasaporte.
- 5 - Karte identifikimi e punonjesit te ISHSH, Ewald Bejaj. Mbyllet me nr.rendor 5(pese). Nga ana jonë u sekuestruan keto sende në cilësinë e provës materiale. Procesverbali pasi lexohet gjendet i rregullt dhe firmoset pa vërejtje.

Personi të cilit iu sekuestruan prova materiale

Ewald Bejaj

Oficeri i Policisë Gjyqësore
Alban Kalaja

Alban Kalaja

Shënim : Sendet e sekuestruara iu dorezuan OPGJ Ledian Kolgjoka.


TË DREJTAT E PERSONIT NËN HETIM

Në bazë të Nenit 34/a të Kodit të Procedurës Penale, ju keni të drejtë :

- I. Të njoftoheni në një kohë sa më të shkurtër, në gjuhën që kuptoni, për veprën penale për të cilën po hetoheni, si edhe për shkaqet e akuzave;
- II. Të përdorni gjuhën që flisni ose kuptoni, ose të përdorni gjuhën e shenjave, si dhe të ndihmoheni nga një përkthyes dhe interpretues nëse keni paaftësi të kufizuar në të folur dhe në të dëgjuar;
- III. Të heshtni, të paraqisni lirisht mbrojtjen tuaj, si dhe të mos u përgjigjeni pyetjeve të caktuara;
- IV. Të mbroheni vetë ose me ndihmën e një mbrojtësi të zgjedhur prej jush;
- V. Të keni një mbrojtës të siguruar nga shteti, nëse mbrojtja është e detyrueshme ose nuk keni mundësi financiare për të patur një mbrojtës, sipas parashikimeve të këtij Kodi dhe legjislacionit në fuqi për ndihmë juridike;
- VI. Të takoheni privatisht dhe të komunikoni me mbrojtësin që ju përfaqëson;
- VII. Të keni kohë të mjaftueshme dhe lehtësi për të përgatitur mbrojtjen;
- VIII. Të njiheni me materialet e çështjes, sipas parashikimeve të këtij Kodi;
- IX. Të paraqesni prova që i shërbejnë mbrojtjes tuaj;
- X. T'ju bëni pyetje dëshmitarëve, ekspertëve dhe të pandehurve të tjerë gjatë gjykimit;
- XI. Të ushtroni të drejta të tjera të parashikuara nga ky Kod.

PERSONI NËN HETIM

Evald Bejef



OFICERI I POLICISË GJYQËSORE

ALBAN KALAJA



Prezent

Avokati mbrojtës

Luan Ndregjoni

0694073402